



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.10.2018 ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 22 tetor 2018.
2. Seancë dëgjimore publike në lidhje me ecurinë e punës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla Nuri Belba dhe Blerina Gjylameti.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Vangjel Tavo, Floida Kerpaçi, Bardh Spahia, Halim Kosova, Grida Shqina, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj dhe Klodiana Spahiu.

Të ftuar:

Arben Seferaj – Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Ariana Pëllumbi - drejtoreshë e Shërbimeve Shoqërore

Irida Qosja – përgjegjëse në Sektorin për Marrëdhëniet e Punës

Eda Beqiri - përgjegjëse në Sektorin e Sigurimeve Shëndetësore

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Përshëndetje të gjithëve!

Sot në rendin e ditës kemi: Seancë dëgjimore publike në lidhje me ecurinë e punës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Të ftuar kemi kryeinspektorin, zotin Arben Seferaj, zonjën Ariana Pëllumbi, zonjën Qosja dhe zonjën Beqiri.

Zoti Seferaj, ju uroj punë të mbarë në detyrën tuaj!

Ne e kërkuam këtë dëgjese që të bëjmë një bisedë të hapur për çështjet e punës. Këto çështje ne si maxhorancë e majtë i kemi në përparësinë tonë, e kemi pasur edhe slogan elektorale dhe më pas e kemi materializuar, tashmë si një kahe e qeverisjes sonë që çështjet e punës, të cilat janë shumë të rëndësishme për sa i përket produktivitetit të një vendi, të sigurohen, por paralelisht me të duhet të sigurohen punëtorët, të drejtat e tyre, por dhe të respektohet ligji në punë.

Ne jemi të vetëdijshëm që për shumë vite çështjet e punës janë fshehur pak dhe prioritetet kanë dalë në rresht të dytë. Kemi dëgjuar shpesh për thithje investimesh, për hapje vendesh pune e të tjera, duke qenë se jemi një vend që ka dalë nga varfëria, por në statistikën e tanishme Shqipëria figuron një vend me të ardhura mesatare, në disa raporte me mesatare të larta dhe kemi nevojë të vëmë në rend edhe çështjet që i përkasin punës.

Në disa prej dëgjësive formale apo informale që kemi bërë në këtë kuadër me Miqtë e Fëmijëve, grupin e Kuvendit apo në seancën e posaçme të Kryetarit të Kuvendit për luftën kundër varfërisë e të tjera, janë ngritur disa herë nga sindikatat në Shqipëri çështje për problematikat e punës, çështje të sigurisë dhe numrin e të vrarëve në punë, janë ngritur çështje për punën e të miturve dhe të pagesave nën rrogën minimale që bëhen shpesh në mënyrë informale, pra paguhet punëtorë pastaj një pjesë e asaj rroge merret në mënyrë informale nga punëdhënësit.

Nga ju si institucioni përgjegjës për këtë punë duam të dimë kushtet në fabrikat tona, në fasoneritë dhe në ndërtim që është një sektor tjetër me rrezikshmëri të lartë.

Raporti në pjesën më të madhe m'u duk shterues, por na erdhi shumë vonë, na erdhi sot. Do të ishte më mirë që ta kishim disa ditë më përpara në mënyrë që edhe deputetët të kishin mundësi të bënin disa komente, por, gjithsesi, e kemi lexuar. Ju ftoj të bëni një prezantim tuajin dhe pastaj të futemi në detaje të pyetjeve apo çështjeve që duan të ngrenë deputetët.

Arben Seferaj – Përshëndetje, zonja drejtuese e seancës!

Përshëndetje të gjithë deputetëve të pranishëm në këtë komision!

Së pari, dua t'ju falënderoj për mundësinë që na jepni që të prezantojmë punën e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, për këtë periudhë që unë jam në detyrën e kryeinspektorit. Prandaj pa humbur kohë dua t'ju bëj me dije një raport paraprak në lidhje me atë çfarë ne eidentojmë gjatë periudhës nga maji deri më sot, por sigurisht që kemi futur brenda edhe periudhën nëntëmujore nga janari deri në shtator të vitit 2018.

Duke iu referuar këtij raporti, dua të theksoj që Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore si një organ i qeverisjes qendrore është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës nga të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën Shqipërisë.

Elisa Spiropali – Zoti Seferaj, ne raportin e kemi përpara, nëse mund të ndaleni vetëm te çështjet kryesore dhe ato që ju eidentoni si më të rëndësishmet për të diskutuar, pastaj për pjesën e diskutimeve dhe pyetjeve ne do t'i referohemi të gjithë raportit në tërësi.

Arben Seferi – Mua më duhet t'i referohem një pjese të këtij raporti për të thënë çfarë kemi bërë ne, me qëllim që institucioni që unë drejtoj të jetë avangard në zhvillimet e mëtejshme.

Gjëja e parë që ne kemi bërë, sepse e kemi parë të domosdoshme, është rindërtimi i faqes zyrtare. Kjo mund të tingëllojë sikur nuk është ndonjë gjë e rëndësishme, por e theksoj këtë për faktin që është shumë e domosdoshme për të pasur një kontakt real me të gjithë personat që janë të interesuar për legjislacionin e punës. Faqja zyrtare përmban informacion të rëndësishëm për çdo të interesuar, punëdhënë, punëmarrës, organizatë sindikale apo publik, si dhe nëpërmjet rubrikave të veçanta, siç është rubrika: “Denonco”, “Njofto aksidentin në punë”, “Kërkesat” e të tjera, adresimi bëhet në kohë reale për çdo fenomen që lidhet drejtpërdrejt me shkelje të legjislacionit të punës. Kemi edhe programin e inspektimeve bazuar në vlerësimin e riskut të informalitetit apo informalitetit në pagë, siç e theksuat në hyrje të këtij komisioni, pasqyrimi i të gjithë historikut të inspektimeve të kryera në regjistrin e subjekteve të Qendrës Kombëtare të Biznesit, që do të shërbejë si bazë programimi.

Rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal me Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përditësimin e të dhënave të subjekteve të reja dhe punëmarrësve të rinj për të monitoruar krijimin e marrëdhënies tyre të punësimit.

I theksoj pasi këto janë masa që kemi ndërmarrë me qëllim që efienca e Inspektoratit të Punës të fokusohet konkretisht aty ku problematika është më e madhe.

Kryerja e procedurës së inspektimit *online* dhe përmirësimet e vazhdueshme në sistemin *e-inspection*, duke bërë të mundur marrjen e formularit E-sig 025 përmes këtij portali pa ngarkuar biznesin me dokumentacion shtesë, sepse deri dje ja kërkonim biznesit, ndërsa sot e kemi në dispozicion. Gjithashtu, po punohet edhe për zhvillimin e formularit tjetër E-sig 027, po për të njëjtin qëllim.

Duke vënë theksin te ligji për marrëdhëniet e punës në fokusin tonë kemi vënë edhe inspektimet në subjektet me aktivitet medie, kemi bërë inspektime në subjektet që ushtrojnë aktivitete gjatë sezonit turistik dhe në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) është iniciuar aksioni në sektorin e ndërtimit.

Pavarësisht se këto i keni lexuar nga materiali që ju kemi dhënë, i them për faktin se është një bisedë e hapur publike dhe që të kuptohet realisht, nga ata që na dëgjojnë, se çfarë ne realisht po prezantojmë.

Inicimi i inspektimeve rastësore duke konsideruar të gjithë ciklin e punës, përfshirë këtu edhe ditët e pushimit javor, festat zyrtare, punën me turne të dyta ose të treta, si dhe në kuadër të reformës së deregulimit, u janë ofruar bizneseve shërbimet online për leje pune, orë shtesë dhe punësim i të miturve.

Një risi e re në Inspektoratin e Punës është hartimi i matricës së dënimeve administrative, e cila do të shërbejë për të vendosur standarde të njëjta për subjektet që kryejnë të njëjtën shkelje ligjore, duke synuar një transparencë maksimale si për punën inspektorëve, ashtu edhe për vetë subjektet. Kjo matricë do të sigurojë edhe mundësinë e monitorimit dhe raportimit të saktë për dispozita të caktuara ligjore, që përcaktojnë standarde punësimi.

Dua të ndalem te pjesa e matricës, meqenëse na u dha mundësia para këtij komisioni. Sinqerisht kemi një kohë të gjatë që po merremi me këtë gjë, sepse u bënë rreth 4 muaj e gjysmë që po merremi me programimin e kësaj matrice. Gjithashtu, dua të theksoj se ka të bëjë jashtëzakonisht shumë me transparencën, duke marrë në konsideratë të vazhdueshme edhe qëllimet e qeverisë për sa i përket transparencës. Kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë më parë dhe nëpërmjet kësaj matrice ne do t'i japim mundësi subjektit që në kohë reale të kontrollojë veten e tij për shkeljet e mundshme, të cilat ai mund t'i ketë në subjektin e tij para se Inspektorati i Punës ta kontrollojë. Kjo gjë do të bëhet e mundur në faqen tonë pikërisht nëpërmjet kësaj matrice. Pra, deri më sot kemi evidentuar problematika nga më të ndryshmet dhe më duhet t'i them këtu, pavarësisht se disa lenë shije jo të mirë, por kjo është transparenca e sotme, nëpërmjet abuzimit që bëjnë inspektorët e punës me inspektimet e tyre në biznese.

Lufta e qeverisë shqiptare është kundër korrupsionit dhe pikërisht kjo që sapo bëjmë është një nga proceset më transparente, që eliminon mundësinë për korrupsion nga ana e inspektorëve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Nuk dua të futem në detaje për faktin se ndoshta koha juaj është e limituar, por edhe jona, gjithashtu, por, sigurisht, ne jemi në funksion të çdo pyetjeje që ju do të bëni në raport me këtë që sapo citova.

Theksoj se detyrat e kryera nga muaji maj deri në shtator të vitit 2018, si dhe efienca e inspektimeve për këtë periudhë krahasimisht me gjithë 9-mujorin e vitit 2018 ka dhënë rezultate konkrete, e përkthyer kjo në shifra: 68% e inspektimeve të kryera në këtë 9-mujor janë rezultat i punës intensive në 5- mujorin maj-shtator të vitit 2018; 61% janë inspektime për shkak ankese; 82% e inspektimeve rastësore iniciuar në subjekte me dyshime për shkelje flagrante të legjislacionit të punës; 90% e zbulueshmërisë së informalitetit në punë; 90% e rikuperimit të kontribuuesve të munguar në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjatë procesit të inspektimit; 92% e masave administrative pezullim për shkelje flagrante të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës; 67% e masave administrative si dënim kryesor paralajmërim dhe 59% e masave administrative si dënim kryesor gjobë.

Sigurisht te ky raport janë të përkthyer kontrollet në subjekte dhe në numër vendesh pune, por nuk e di nëse ju dëshironi t'i dëgjoni, pavarësisht se e keni materialin para. Kështu që po mundohem, referuar asaj që kryetarja përmendi, të kursej këto shifra për të dalë te prioritet konkret.

Dua të theksoj se problematikë “pozitive” është pjesa e ankesave. Kjo pjesë ka njohur rritje gjatë kësaj periudhe, sipas regjistrimit të ankesave ku regjistrohen të gjitha ankesat drejtuar institucionit tonë. Si në drejtorinë qendrore, ashtu edhe në degët rajonale për këtë vit janë regjistruar 486 ankesa, të cilat, në varësi të objektit të ankimit, janë trajtuar me inspektime apo verifikime rast pas rasti.

154 subjekte janë inspektuar në kuadër të ankesave të ardhura, kurse diferenca janë trajtuar me informacione pas verifikimeve të bëra ose ankesa, të cilat na figurojnë të ridrejtuar pranë nesh me të njëjtin objekt ankimimi si më parë.

Arsyet e ankesave janë renditur si më poshtë: cenim të marrëdhënieve të punës, 264 ankesa; mospagesë e pagave të prapambetura, 52 ankesa; ndërprerje e marrëdhënieve të punës, 47 ankesa; mospagesë e sigurimeve shoqërore, 24 ankesa; punësim i paligjshëm, të huaj dhe të mitur, 15 ankesa; mospagesë e raporteve, 4 ankesa; mosnjohim aksidenti në punë, 11 ankesa; mosrespektim të orëve të punës, 3 ankesa; kushtet e punës, 9 ankesa; diskriminimi, 3 ankesa; për inspektorët, 8 ankesa; informim dhe sqarim, 46 ankesa. Pra, në total janë 486 ankesa.

Në përqindje sipas zgjidhjes së ankesave rezultojnë: 40,3% janë ankesa të zgjidhura plotësisht në favor të ankuesve; 28% janë ankesa të zgjidhura pjesërisht në favor të ankuesve; 19% janë ankesa, të cilat nuk janë zgjidhur; 12,7% janë ankesa në proces trajtimi.

Moszgjidhja e ankesave lidhet me një sërë faktorësh, ku më kryesorët përmendim: subjekti ndaj të cilit është adresuar ankesa nuk ushtron aktivitet; disa pretendime të ankesës tejkalojnë kompetencën e inspektorit të punës për zgjidhje; si dhe nuk gjenden të justifikuara pretendimet e ngritura pas verifikimit të kryer nga inspektori. Në të gjitha rastet vlen të theksohet se të gjithë ankuesit janë njoftuar zyrtarisht në lidhje me problematikën e ngritur prej tyre në ankesën e adresuar pranë institucionit tonë.

Ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes kundrejt institucionit tonë janë 107 ose 22% e ankesave të regjistruara nga trupa inspektuese janë trajtuar brenda të gjitha afateve ligjore.

Ndërkohë, sipas zgjidhjes i kemi: 33% janë raste të zgjidhura; 24% janë raste të zgjidhura pjesërisht ; 26% janë raste që nuk janë zgjidhur; 17% janë raste në proces trajtimi.

Nga të gjitha degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore trajtimi i ankesës, i mbikëqyrur drejtpërdrejt nga Drejtoria Qendrore, ka qenë dhe është një prioritet i punës. Në trajtimin e rasteve të ankesave, që janë evidentuar edhe gjatë bashkëpunimit me platformën e bashkëqeverisjes, lidhen me subjekte problematike që kanë detyrime ndaj punonjësve, të evidentuara nga ISHPSHSH-ja për shkeljet ligjore të evidentuara gjatë kontrolleve të ushtruara inspektori vendos masë administrative: gjobë, sipas legjislacionit në fuqi dhe për çdo rast konkret përcaktohet detyra e karakterit udhëzues për shlyerjen e detyrimit, ku primare janë pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Në shumë raste të kësaj natyre subjektet mbyllin aktivitetin fiktivisht, ndërkohë që në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezultojnë me status aktivë. Në këto kushte vendimi i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore mbetet vakum dhe problemi i qytetarit mbetet pezull.

Një ndër sektorët më problematikë për sa u përket ankesave që adresohen, dua ta veçoj këtë gjë është shërbimi privat i ruajtjes së sigurisë fizike. Krahas sektorëve të tjerë për shkak edhe të numrit të lartë të ankesave që adresohen për mosrespektimin e nivelit të pagës minimale të përcaktuar për këtë sektor, që përcaktohet 50% më shumë se niveli minimal i pagës së përcaktuar me VKM, ku paga minimale është 24 mijë lekë, kurse këtu, te ky sektor është 36 mijë lekë. Ky është një nga sektorët me problematikë që ne kemi hasur në punën tonë të përditshme.

Dua të nënvizoj përsëri se faqja zyrtare, ka pësuar një rritje të numrit të shikueshmërisë, që nga riformatimi i saj që në muajin qershor dhe është thjeshtuar informacioni që përmban kjo faqe për t'u kuptuar nga publiku i interesuar.

Unë kërkoj mbështetjen tuaj për një drejtori që kemi, e cila quhet Drejtoria e Inspektimit të Standardeve për Shërbimet Shoqërore. Këtu, ndoshta do të zgjatëm pak, pavarësisht se e kuptoj kohën tuaj të racionuar, pasi mendoj se është e rëndësishme që kjo drejtori të marrë trajtimin e duhur dhe vëmendjen tuaj për të pragmatizuar një sërë ligjesh që janë aktualisht. Në vitin 2012 Inspektoratit Shtetëror të Punës iu ngarkua përgjegjësia e inspektimit të standardeve të shërbimeve shoqërore, përgjegjësi që më parë ishte funksion i Shërbimit Social Shtetëror. Delegimi i kësaj përgjegjësie u shoqërua me krijimin në drejtorinë qendrore të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të një drejtorie të veçantë: Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore me përgjegjësi dhe kompetenca të plota në fushën e kontrollit të subjekteve publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, bazuar në ligjin nr. 9355 dhe VKM-së përkatëse në zbatim të saj. Drejtoria e Inspektimit të Standardeve ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimit të kujdesit shoqëror. Kjo drejtori në përmbushje të misionit të saj dhe detyrës funksionale ka mbuluar të gjithë territorin e vendit me inspektimin e ofruesve të shërbimit të kujdesit shoqëror, bazuar në një plan vjetor inspektimi, objektivat e të cilit kanë synuar përfituesin dhe cilësinë e shërbimit, trajtimin e përfituesit me dinjitet dhe verifikimin e garancive për mirëqenien e përfituesit për mbrojtjen, zhvillimin dhe integrimin e tij. Si pjesë e punës së kësaj drejtorie nëpërmjet propozimit të masave dhe rekomandimeve të dhëna është insistuar në forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve, veçanërisht të njësive përkatëse të qeverisjes vendore si një aktor shumë i rëndësishëm për garantimin dhe ofrimin e të drejtës së mbrojtjes sociale për çdo individ, familje apo komunitet në nevojë. Subjektet, objekt i inspektimit të inspektorit të Drejtorisë së Inspektimeve dhe Standardeve të Shërbimeve Shoqërore janë të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror: publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, duke filluar nga bashkitë, drejtoritë e shërbimeve shoqërore në bashki, shërbimet komunitare, shërbimet në familje, kujdestaritë, shërbimet rezidenciale ditore, shërbimet e kujdestarisë familjare, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, ndërmarrjet sociale, si dhe çdo lloj shërbimi komunitar që u ofrohet njerëzve në nevojë. Bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori, informacioni i së cilës përditësohet nga inspektimet e kryera evidentohet se duhet të ofrojnë shërbimet për përkujdes shoqëror në një numër prej 296 subjektesh publike dhe jopublike. Këto janë të

ndara: 92 shërbime rezidenciale, 91 qendra ditore, 8 qendra multidisciplinare dhe 105 shërbime komunitare.

Nga kontrollet e ushtruara konstatohet se përgjithësisht cilësia e shërbimit në institucionet publike dhe jopublike referuar kjo plotësimit të standardeve të shërbimeve ka ndryshime cilësore në krijimin e kushteve të jetesës. Ato kanë nevojë të përmirësojnë punën e stafit dhe të mbështeten me figura profesionale si: psikologë, mjekë specialistë, terapistë të ndryshëm. Qendrat publike duhet të kenë struktura më fleksibël në numër dhe në profesion. Vlerësojmë se përcaktimi i strukturave të këtyre qendrave me VKM është kapërcyer si stad. Kjo është reflektuar edhe në evidentimin e faktit se shërbimet jopublike janë më fleksibël në adaptimin e strukturës së stafit me figura profesionistësh në përgjigje të modelit të shërbimit dhe të nevojave të përfituesve.

Gjithashtu, konstatohet se detyrat e lëna institucioneve publike, detyra në përgjegjësi dhe në kompetencë të drejtuesve të qendrave janë realizuar, ndërsa detyrat që kërkojnë përgjegjësinë apo vendimmarrjen e bashkisë, nuk janë realizuar. Këtyre institucioneve u është bërë me dije se moszbatimi në vijim i detyrave të lëna do të përbëjnë shkak që të propozohen për masa administrative në inspektimin e radhës.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr.121, datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” shërbimet e kujdesit shoqëror, tipologjitë e shërbimeve, përgjegjësitë e aktorëve ofrues të shërbimeve, standardet e këtyre shërbimeve, si dhe roli e përgjegjësitë e organit inspektues përfshihen në një proces rishikimi dhe miratimi të një pakete të tërë aktesh nënligjore.

DISSSHH-ja në përmbushje të përgjegjësisë së saj, tashmë bazuar në ligjin e ri për vitin 2019 ka dy objektiva kryesorë:

- 1.Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimin e respektimit të standardeve të shërbimeve, duke vlerësuar me prioritet respektimin e të drejtave të përfituesve.

- 2.Njohjen dhe respektimin e standardeve të shërbimeve, rritjen e kujdesit, por edhe kapaciteteve të pushtetit vendor, nëpërmjet inspektimit të qendrave të shërbimeve komunitare të krijuara nga bashkitë, në kuadër të rolit dhe të përgjegjësisë të marra nga bashkitë me ligjin e ri.

Nëse do të bënim një përlllogaritje numerike të subjektet për t’u kontrolluar nga inspektorati në tërësi shkojnë në 430 qendra, struktura dhe njësi lokale. Me burimet aktuale që ka Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore pranë ISPSHHH-së mund të realizojë inspektime vetëm për 29% të tërësisë së subjekteve që duhen inspektuar, gjithmonë

referuar ligjit të ri. Pra, është e nevojshme nxitja dhe mbështetja e çdo aktori, ku ju jeni aktorët më të mëdhenj në këtë proces për të përshpejtuar rritjen dhe forcimin e kësaj drejtorie.

U zgjata pak për këtë pjesë për faktin se është një pjesë që prek shtresën më në nevojë të shoqërisë, e cila ka marrë një vëmendje jashtëzakonisht të madhe nga qeveria shqiptare. Ju jeni mekanizmi që

mund ta përshpejtojë akoma më tepër këtë gjë.

Elisa Spiropali - Faleminderit, zoti Seferaj!

Ka ndonjë shtesë për të bërë nga zonja?

Ariana Pëllumbi - Me daljen e ligjit të ri nr. 121 në nëntor të vitit 2016 struktura jonë si Drejtori e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore presupozohet të bëhet një strukturë e pavarur në varësi të ministrit përkatës, kjo për vetë faktin se kompetencat e kësaj drejtorie shtohen me 80% sipas ligjit të ri, ku rriten shërbimet e reja. Me rritjen e shërbimeve të reja si: shërbimi në familje, shërbimi i emergjencës dhe shumë shërbime të tjera, duke u dhënë kompetencë të plotë bashkive, kompetencat e kësaj drejtorie për të kontrolluar drejtoritë e shërbimit shoqëror në bashki dhe në të gjithë komunitetin shkojnë rreth 80%, ndërkohë që drejtoria jonë përbëhet nga 4 inspektorë dhe një drejtor, duke e bërë gati të pamundur inspektimin, duke u mbështetur të ligji i ri, i cili është aprovuar, por aktet nënligjore kanë 2 vjet që nuk janë miratuar. Kjo gjë e bën atë të pazbatueshëm dhe ne të pamundur për të inspektuar të gjithë komunitetin në të gjithë territorin e vendit.

Në mungesë të këtyre akteve ne e kemi të pamundur inspektimin për të gjitha llojet e shërbimeve të reja që pasqyrohen në ligjin e ri.

Elisa Spiropali - Këtë shqetësim konkret a ia keni përcjellë kreut të institucionit, ministrit për Financat dhe Ekonominë, e kam fjalën përmes inspektoratit?

Ariana Pëllumbi - Të gjitha këto janë bërë. Fillimisht me Ministrinë e Shëndetësisë, ku janë bërë *memo*, propozime për VKM të veçanta, lidhur me strukturën tonë. Janë bërë propozime për aktet nënligjore...

Elisa Spiropali - Meqenëse keni kaluar nga struktura e Ministrisë për Mirëqenies Sociale në strukturën e Ministrisë së Financave, ka nevojë për informacion...

Ariana Pëllumbi - Ne ia kemi bërë me dije Ministrisë së Financave, ministrit, në lidhje me pjesën që ne jemi si strukturë e pavarur. Jemi në varësi të tyre, por lidhjet ose varësia, një varësi dyfishe, i takon Ministrisë së Shëndetësisë.

Këto kanë qenë në vazhden e të gjitha materialeve që janë dashur, si dhe...

Elisa Spiropali – Dakord! E kuptuam. Në rregull. E kemi të qartë. Vetëm desha t'ju pyesja nëse ia keni bërë prezente ministrit të Financave.

Mirë. Le ta hapim me pyetje e diskutime nga deputetët, dhe pastaj vazhdojmë.

Pendavinji, e pastaj zonja Bode.

Ilir Pendavinji – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit që keni ardhur të na informoni në lidhje me punën që ka kryer inspektoriati gjatë nëntëmujorit të vitit 2018, janar-shtator. Në bashkëqeverisje me qytetarët, ankesat që kanë ardhur iu referohen kryesisht juve direkt, dhe ju merreni me zgjidhjen e tyre në terren. Pastaj, raporti tregon pjesën e përqindjes që keni zgjidhur ose që jeni në proces. Po shikoja një pjesë të rëndësishme të asaj që ju keni si objekt të punës, ku ju flisni në lidhje me pajisjen e subjekteve private me mjekë, prej të cilave, siç referoni ju, nga 1724 janë 1020. Ndërkohë, me këto 704 të tjerat çfarë bëhet? Kanë qenë objekt i kontrollit tuaj këto subjekte, të cilat nuk janë pajisur me këtë, por edhe pjesa tjetër që unë iu referova, Këshilli i Sigurisë së Shëndetit. Nga 892 objekte, janë evidentuar 530 që e kanë ngritur këtë.

Domethënë, ideja është: me këtë diferencë ndërmjet numrit të të evidentuarve dhe numrit të atyre që kanë qenë objekt i kontrollit tuaj, pjesa tjetër nuk është kontrolluar akoma?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po bëj pyetjen, njëherë, pastaj mund të më përgjigjeni.

Si pjesën më të rëndësishme kisha këtë të mjekëve, duke qenë se shumica këtu janë mjekë, pra një pjesë e mirë e kolegëve tanë janë mjekë. Në lidhje me çështjen e mjekëve, çfarë detyrash janë lënë në këto subjekte, për t'u kërkuar? Po ashtu, edhe për pjesën e Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve.

Ju thoni se duhet të inspektoni rreth 492 subjekte, në mos gabohem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

430 qendra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me katër inspektorë, ju duhet të kontrolloni gjithë këto qendra?

Faleminderit!

Arben Seferaj – Në lidhje me pyetjen që ju bëtë, fillimisht do të jap një përgjigje. Pastaj, për diçka më teknike do të flasim edhe zonja Qosja dhe zonja Beqiri.

Jo më kot unë desha t'i referohesha çështjeve të ankesave, sepse e përmendët pjesën e ankesave. Sigurisht, për ne është një nga prioritetet maksimale të shqyrtojmë çdo ankesë që na vjen në institucion. Qëllimisht e kam paraqitur me përqindje, për të parë se sa qëndron ky raport në lidhje me totalin e ankesave të paraqitura. Jo çdo ankesë që i adresohet institucionit tonë mund të marrë zgjidhje, dhe kjo për arsye nga më të ndryshmet.

Sigurisht, për një pjesë e ankesave që vijnë, realisht ankimuesit nuk kanë të drejtë. Përgjigjen na ua bëjmë zyrtare. Nuk është se u themi me gojë që nuk kanë të drejtë për ankesat që kanë bërë. Pra, për çdo ankesë që evidentohet në Inspektoriatin Shtetëror të Punës ne japim përgjigje zyrtare.

Për sa i përket çështjes së mjekëve nëpër institucione, dihet se nga ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, çdo subjekt i cili ka një numër më të madh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më korrigjo, Eda!

Eda Beqiri – A mund ta sqaroj?

Arben Seferaj – Po. Mund ta sqarosh më mirë këtë pjesë.

Eda Beqiri – Në lidhje me numrin që përmendët, kur thatë: 1020 subjekte, po 700 të tjerat, ne i jemi referuar nëntëmujorit. Për nëntëmujorin janë regjistruar 1724 subjekte me mjekë ndërmarrjeje. Nga këta, 1020 janë vetëm për pesëmujorin. Pra, kemi një rritje të shtuar të interesit në subjektet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është diferenca e nëntëmujorit me pesëmujorin. Kështu, në këto 1724 janë gjetur subjekte me mjekë ndërmarrjeje, me shërbim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, 1020 jua vetëm për pesëmujorin. Kjo është diferenca e shifrave që po lexonit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa subjekte kanë? Nga 7725 subjekte të inspektuara për nëntëmujorin, kemi 1724 subjekte me mjekë ndërmarrjeje. Pjesa tjetër, në rast se nuk kanë mjekë janë lënë detyra. Pastaj, përjashtohen subjektet me 1 plus 2 punëmarrës... Ky është problemi më i madh që kemi ne: shërbimi me mjekun ndërsujektor. Ka shumë biznese që kanë 1 plus 1, 1 plus dy punëmarrës, të cilët s’dinë kujt t’i drejtohen për të gjetur mjekë ndërmarrjeje. Sepse, aktualisht, ligji thotë: “Për subjektet e grupit ‘a’ dhe ‘b’, mbi çdo 700 punëmarrës duhet të ketë shërbime mjeku, pra një mjek me kohë të plotë. Nëse nuk ka 700 punëmarrës, por më pak, mund të ketë mjek me kohë të pjesshme. Grupet ‘c’ dhe ‘d’, që nuk paraqesin risk për sigurinë dhe shëndetin në punë, për çdo 1500 punëmarrës duhet të kenë shërbimin me mjek ndërmarrjeje.

Kjo është diferenca. Prandaj mund të ketë lëvizje edhe në numër subjektesh, të mbuluara ose jo me shërbimin shëndetësor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Pjesa më e madhe e formalitetit është në diferencën ndërmjet pagës së deklaruar dhe pagës që punonjësit marrin në dorë. Më shumë e kanë kështu SHRSF-të. Si

po veprohet me këta? Ne jemi të gjithë në terren. Jemi në terrene dhe nëpër zonat tona, dhe të gjithë policët e SHRSF-ve, pothuajse të gjithë, referojnë: ne nuk e marrim rrogë sa ç'e kemi në kontratë. Punojnë me kartën e bankës.

Arben Seferaj – Prandaj dhe unë e paraqita pranë jush si një sektor, i cili është një nga më problematikët në vend. Sigurisht, ne kemi komunikuar nëpërmjet letrave zyrtare, drejtuar deri dhe Ministrisë së Brendshme. Këtu ka një problematikë, të cilën duhet ta shprehim. Lejet e dhëna për institucione të tilla kanë qenë... Unë nuk e di, se s'është në kompetencën time për ta gjykuar këtë gjë, po për mendimin tonë, me ato që shohim, lejet kanë qenë pa kriter. Sigurisht, hapja e shumë SHRSF-ve sjell këtë lloj problematike, dhe humbet serioziteti, gjë që përkthehet te pagesat. Sepse, në fund fare, të gjitha përkthehen në pagesa për punonjësit e tyre.

Brenda Kodit të Punës, ne mundohemi të zgjidhim të gjitha problematikat që evidentohen në bazë të ankesave që paraqesin punonjësit pranë këtyre shoqërive. Deri në këtë çast ia kemi dalë mbanë, mirëpo problemi kalon më tutje. Kjo është një problematikë, që neve na vjen përditë, prandaj, që të ketë një frenim, sigurisht që duhet një bashkëveprim institucional ndërmjet disa ministrive, për të zbutur ose për ta zhdukur këtë lloj fenomeni.

Elisa Spiropali – Unë kam një pyetje konkrete në lidhje me këtë, dhe faleminderit që ishit kaq i hapur për ta ngritur si problematikë. Ne jemi të gjithë deputetë nëpër zona, ndaj e dimë mirë si funksionojnë këto shoqëri të sigurimit fizik, dhe si i paguajnë punonjësit.

Në momentin që konstatojmë se një shoqëri e tillë është në shkelje të ligjit, duke qenë se u merr pagën punonjësve pasi ua ka kaluar në kartë e të tjera. Këtu keni specifikuar se vini gjoba, se keni mbledhur kaq e aq gjoba. Në sa varion gjoba? Pra, ju e konstatojmë që ka një problematikë të tillë. Detyra juaj është të vendosni një gjobë, por subjekti mund ta paguajë atë gjobë dhe pastaj mund ta shkelë ligjin sërish e sërish. A ka nevojë të rregullohet ky mekanizëm? A i ndërpritet veprimtaria një subjekti të tillë?

Arben Seferaj – Nuk është në diskrecionin tonë për të përcaktuar nëse i ndërpritet apo jo. Në diskrecionin tonë është vetëm marrja e masës administrative.

Elisa Spiropali – Sa është gjoba? Sa është masa?

Arben Seferaj – Gjoba varion. Maksimalja është pesëdhjetëfishi i rrogës minimale, që është 36 mijë lekë herë pesëdhjetë që shkon 1 milionë e 800 mijë lekë të rinj. Flasim për rastet ekstreme.

Elisa Spiropali – A u keni vendosur ju gjoba të tilla subjekteve që keni konstatuar?

Arben Seferaj – Jo dhe do t'ju them edhe arsyen pse nuk janë vënë. Në momentin kur neve na drejtohet një grup punëmarrësish të një SHRSF-je për probleme me pagesën,

qëllimi ynë si institucion është që këta persona të përftojnë pagesën për shërbimet e kryera. Ky është qëllimi ynë, sepse ne jemi në mbrojtje të punëmarrësve. Në momentin kur ne e shoqërojmë me një gjobë, e cila e mbyll aktivitetin, jam dakord që bëme një gjë, pra ai do ta mbyllë aktivitetin, siç e bëjnë realisht një pjesë, por, nga ana tjetër, nuk zgjidhëm absolutisht asgjë për punëmarrësit. Domethënë, çfarë bëme ne në këtë rast?! Prandaj ajo që ne kërkojmë është që nëpërmjet bashkëveprimit ndërinstitutional, ku është Ministria e Financave, në varësinë e secilës ne jemi, Ministria e Brendshme, e cila merret me licencat...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo.

Ilir Pendavinji – Një sektor i rëndësishëm ku mund të abuzohet janë kamerierët në lokale. Nuk besoj se një kamerier e merr rrogën minimale, sepse i kam parë ata kur shkoj pi kafe. Është një sektor shumë i madh, ku punëtorët nuk marrin aq sa duhet.

Arben Seferaj – Ne e kemi theksuar edhe te raporti ynë që sektori i tregtisë dhe shërbimeve është problematik. Nga ana tjetër, duhet të kuptojmë mundësitë që ka aktualisht Inspektorati i Punës. Dua të theksoj se sot Inspektorati i Punës ka një trupë të përbërë nga 154 persona.

Elisa Spiropali – Ju keni vetëm 98 veta në terren. A janë të mjaftueshëm ata?

Arben Seferaj – Do t’jua them unë se sa të mjaftueshëm janë 98 vetë të përkthyer në praktikë pune dhe në përqindje të mbulimit të biznesit: ne nuk mbulojmë dot më shumë se 6% të biznesit aktiv në Republikën e Shqipërisë. Domethënë, e kuptoni vetë se sa është mundësia jonë reale për të bërë këtë gjë. Për këtë arsye po mundohemi të krijojmë mekanizma, të cilët do të na ndihmojnë ne, pra është ajo matrica për të cilën po diskutoja pak më parë, për të zgjeruar veprimtarinë tonë. Kështu që ne evidentojmë problematika, marrim masa administrative, i mbështesim sindikatat, por, në fund të fundit, kjo është mundësia jonë.

Elisa Spiropali – Qartë.

Fjalën e ka zonja Bode.

Edlira Bode – Shumë faleminderit, zoti Seferaj, për çdo gjë që thatë deri tani!

Problematika që do të ngre unë është konkrete dhe është një ngjarje absurde, e pazgjidhur ende, edhe pse ka vite, dhe që nuk ndodh me subjekte private, por brenda institucioneve shtetërore, brenda institucioneve të arsimit parashkollor. Në zonë që unë përfaqësoj janë të paktën 6 kopshte, të cilat funksionojnë me nga 2 edukatorë.

Në bazë të legjislacionit, Ministria e Arsimit ka emëruar punonjësen, ndërkohë që kjo e fundit duhet të paguhet nga njësia e administrimit vendor, nga bashkia. Bashkia nga ana e saj, duke keqinterpretuar, në gjykimin tim, ligjin ka emëruar një tjetër person, të cilin vazhdon

e paguan. Ndërkohë që aty ka 5 vjet me edukatore të dubluara, të cilat shkojnë të dyja në të njëjtën klasë mësimi dhe fëmijët janë të çorientuar, kurse ato të dyja nuk kanë marrëdhënie të mira me njëra-tjetrën, pra ndoshta edhe debatojnë. Kjo është në dëm të mirërritjes dhe miredukimit të fëmijëve. Ndërkohë, kur e kam paraqitur këtë shqetësim të elektoratit në Inspektoratin rajonal më është thënë se nuk mund ta zgjidhnin ata, por duhet t'i drejtohen gjykatës. Është e vërtetë që ato kanë hapur gjyq dhe janë duke u zhvilluar proceset gjyqësore. Shqetësimi im është që nuk arrijmë të zgjidhim një problematikë brenda institucioneve shtetërore nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror. A kanë këto kopshte një bordero?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se është kompetenca juaj në momentin kur kemi një punonjëse të emëruar, e cila nuk merr pagën dhe nuk i paguhen sigurimet shoqërore. Pra, kemi një institucionin që ka punonjës, të cilët nuk i deklaron dhe nuk u paguan sigurimet shoqërore. A është kompetenca juaj kjo?

Arben Seferaj – Unë ju falënderoj për informacionin! Në dijeninë time, sot po më bëhet i ditur një rast i tillë. Ne kemi pasur raste të ngjashme. Personalisht sot po njihem me një rast të tillë. Në përgjithësi, ne kemi një drejtor që merret vetëm me problematikën e ankesave. Nuk e njoh rastin. Gjithsesi, ne kemi detyrimin dhe pjesën tonë për të vënë çdolloj argumenti në favor apo në disfavor të dikujt që dublon një vend pune me dy persona.

Edlira Bode – A kemi në një mekanizëm kontrolli mbi bashkinë në këtë rast?

Arben Seferaj – Sigurisht, ajo që mund të them unë, por Irida do ta shpjegojë më teknikisht, është se ne kemi pasur raste të ngjashme në subjekte shtetërore. Ankesat e qytetarëve, që kanë vuajtur një situatë jo të drejtë, kanë marrë zgjidhje. Ato janë drejtuar si ankesa edhe nëpërmjet platformës, por edhe direkt në institucion nëpërmjet faqes sonë zyrtare.

Edlira Bode – Çfarë zgjidhje jepet në këtë rast?

Bëhet fjalë për Bashkinë e Devollit dhe janë 6 kopshte. Në dijeninë time, edhe prefektura e Korçës ka bërë një ankimim në gjykatë dhe janë në një proces gjyqësor. Pra, bashkia sot përballë me dy procese gjyqësore, edhe individualisht nga punonjëset, edhe nga prefektura e Korçës. Kjo çështje do të zgjidhet në gjykatë, ndërkohë që ne nuk i zgjidhim dot këto probleme midis institucioneve shtetërore.

Irida Qosja – Atëherë, për rastin konkret do të bëjmë një verifikim të të gjithë praktikës, meqenëse thotë se Inspektorati i Punës i Korçës është shprehur për këtë situatë. E kemi hasur si problematikë jo me edukatorët, por me rojet dhe me pastrueset në shkollë dhe në kopshte. Arsyeja që nuk ka marrë një zgjidhje përfundimtare nga Inspektorati i Punës,

domethënë që të zgjidhet përfundimisht situata, lidhet me faktin që kanë varësi të dyfishtë. Pra, këto institucione, në bazë të ligjit, ka një varësi të dyfishtë.

Edlira Bode – Ligji i ndan kompetencat dhe e përcakton qartë si është varësia.

Irida Qosja – Sigurisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Tani, por jo më parë. Ndërkohë, këto janë punonjëse të emëruara më parë.

Irida Qosja – Jemi përpjekur t'i adresojmë, më saktë, i kemi adresuar problematikat edhe të Bashkisë së Tiranës, edhe të Bashkisë së Beratit. Kemi komunikime zyrtare që e adresojnë realisht problematikën. Bashkia e Beratit ka qenë objekt i kontrollit tonë për çështjen e zjarrfikësve. Behej fjalë pikërisht për këtë lloj konflikti.

Elisa Spiropali – Pak më konkrete. Në rastin kur konstatojnë se kjo ka ndodhur në Bashkinë e Devollit, ju çfarë masash merrni? Pra, deri ku shkon kompetenca juaj?

Irida Qosja – Kompetenca jonë është masa administrative. Kjo do të thotë që lihen detyra urdhëruese për t'u zbatuar, të cilat shoqërohen me sanksione.

Elisa Spiropali – Sa janë këto sanksione? Sa bashki keni gjorbitur apo në sa bashki keni vendosur sanksione?

Në raportin që keni sjellë po lexoj se bashkitë, për sa i përket respektimit të detyrave dhe kompetencave ligjore të tyre me qendrat e kujdesit janë më problematike. Atëherë, në raport me bashkitë, çfarë masash janë marrë dhe sa bashki janë evidentuar si problematike?

Irida Qosja – Lidhur me pyetjen se në sa bashki janë marrë masa konkrete, nuk është operuar me sanksione në bashki, sepse realisht këto çështje që na janë adresuar janë të vitit të fundit. Për rastin e Bashkisë Devoll, më duhet ta verifikoj, sepse nuk më rezulton në regjistrin qendror të ankesave. Për këtë çështje ne do të shprehemi zyrtarisht se si është ndjekur dhe si do të ndiqet.

Edlira Bode – Unë do ta ndjekë këtë çështje dhe do të vij ta marr përgjigjen te ju, por ju siguroj që nuk është çështje e vitit të fundit, madje në dy vjetët e fundit nuk qëndron si problematikë, sepse ka ndryshuar edhe ligji, edhe varësia dhe bashkia është vetë kompetente për emërimin. Unë flas për një periudhë para dy vjetësh, kur i emëronte Ministria e Arsimit dhe duhet t'i paguante bashkia. Pas shumë përpjekjesh, pasi punonjëset janë ankuar në disa institucione, çështjet kanë shkuar në gjykatë, kanë kaluar në Shkallën e Parë, ku ato kanë fituar gjyqin dhe para pak ditësh kjo çështje ka shkuar edhe në Apel. Domethënë, kjo çështje ka shumë kohë, nuk është e viteve të fundit.

Faleminderit!

Arben Seferaj – Ju thoni se është kohë e gjatë dhe pa diskutim që ashtu duhet të jetë, sepse ju jeni e familjarizuar me këtë çështje, por problemi është se Inspektorati Shtetëror i Punës nuk ka asnjë mundësi të prononcohet në momentin që kjo çështje është në gjykatë, ligjërisht nuk na lejohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e di pse s'ka shkuar në gjykatë para 4 vjetësh, para dy vjetësh apo para 1 viti, por kjo është situata.

Elisa Spiropali – Kjo nuk është personale, por lidhet me institucionin, sepse ai ka një vazhdimësi. Ajo që vihet re shpesh në inspektoratet tona është që ata janë të mirë për t'i evidentuar problematikat, por jo për të ushtruar të drejtat që i jep ligji, siç janë sanksionet, gjrobat e të tjerë, domethënë për t'u ndjerë pesha e punës që ju bëni.

Në rastin konkret ne folëm për subjektet e sigurisë dhe të mbrojtjes së personave. Unë nuk e vë dorën në zjarr, sepse nuk i di statistikën, por jam e sigurt se shumica prej tyre nuk kanë marrë asnjë sanksion dhe nuk u është vendosur kurrë një gjobë që ata ta ndiejnë në buxhetin e tyre dhe të mos e përsërisin.

Arben Seferaj – Pak më parë thatë që nuk është personale. Sigurisht që unë nuk marr asgjë personale, por për periudhën që jam unë aty mbaj mend që kemi pasur rreth tre ose katër çështje me SHRSF-të dhe të katër çështjet janë penalizuar, ku masa administrative ka qenë 500 mijë lekë të rinj. Kështu që janë marrë masa administrative. Për momentin nuk e kam informacionin se sa kanë qenë këto masa administrative të ndërmarra nga institucioni ynë në vitet e mëparshme, por mund ta gjej dhe jam i gatshëm t'ju nis nëpërmjet adresës së *email-it*.

Elisa Spiropali - Një çështje tjetër që më shqetëson është ajo që bashkitë në hierarkinë e tyre shërbimet shoqërore i kanë të fundit, prandaj ndodh edhe kjo që ju thoni. Pra, ju evidentoni diçka, por bashkia e ka lënë në fund të listës dhe nuk e bën kurrë. Këtu nevojitet edhe ndërhyrja më e fortë dhe ky ishte qëllimi ynë. Ne kemi qëllim të përbashkët t'ju mbështesim ju dhe të ngremë zërin për rritje kapacitetesh dhe këtë raport do ta dërgojmë edhe në ministri, por edhe ju të mund të imponoheni përmes asaj që ju jep ligji, të drejtën për funksionet e pushtetit lokal, që është shumë i rëndësishëm për garantimin e disa standardeve për shërbimet shoqërore.

Ariana Pëllumbi – Në bazë të ligjit 121, duhet të na jepet kompetenca për të kontrolluar bashkitë dhe drejtoritë e shërbimit shoqëror. Aktualisht ne nuk mund ta bëjmë këtë gjë, sepse aktet nënligjore nuk janë aprovuar akoma. Pra, dëshira jonë është për t'i kontrolluar...

Elisa Spiropali - Ku kanë ngelur këto akte nënligjore, sepse janë bërë si mite?

Ariana Pëllumbi - Këto akte nënligjore kanë ngelur në Ministrinë e Shëndetësisë, sepse UNICEF-i ka marrë përsipër të hartojë të gjitha aktet, që janë pjesë e ligjit nr. 121. Pra, me ligjin e ri të zbatueshëm do t'i kemi objekt kontrolli të gjitha bashkitë, njësitë e mbrojtjes së fëmijës, ndërmarrjet sociale dhe të gjithë komunitetin.

Zoti Xhelilaj, fjala për ju.

Roland Xhelilaj – Në vazhdim të problemit që ngriti kryetarja e komisionit, materialin e pashë me vëmendje dhe kam bindjen se rezultatet e periudhës janar-shtator janë pozitive.

Në vazhdim të asaj që ju theksuat, zoti Seferi, te matrica unë kam një lloj opinionit dhe pyetjeje bashkë. Patjetër që matrica është objekt i punës suaj në zhvillim e sipër, por dua të di nëse ka afat kohor. Kjo për arsyen se matrica përcakton mënyrën e funksionimit të subjekteve, por në të njëjtën kohë i jep një lloj detyrimi inspektoratit tuaj që të jetë korrekt dhe konkret kudo ku ai shkon, pa u gjykuar në mënyrë subjektive nga inspektorët e subjektit të të njëjtit lloj. Nga informacionet që kam, e ndiej rritjen e kontrollit të Inspektoratit në qarkun e Durrësit, por shqetësim im është nëse ka afat kohor ose jo matrica.

Lidhur me Drejtorinë e Inspektoratit, më duket se ka një lloj paqartësie te ju. Jeni të paqartë se çfarë do të bëjë ky inspektorat brenda jush dhe se çfarë keni ju për detyrë të bëni që ky të funksionojë. Sot ishte momenti, ku mund të paraqisnit edhe disa kërkesa, pavarësisht se kanë lidhje me ministrinë, por edhe komisioni të njëjti me nevojat që ka drejtoria juaj në mënyrë që të funksionojë më mirë në periudhën në vazhdim, pastaj realizimi është diçka tjetër. Megjithatë, ju inkurajoj për punën e bërë.

Arben Seferi – Faleminderit, zoti Xhelilaj!

Në lidhje me kërkesat që ne kemi, sigurisht që i kemi bërë prezente pranë ministrisë, por, duke qenë se po bëhet një përshtatje e legjislacionit, që ne aktualisht kemi, me atë të Bashkimit Europian dhe duke qenë se është ngritur një grup pune, i drejtuar nga zonja Senida Mesi, zëvendëskryeministre, të cilët po merren me riorganizimin e të gjitha inspektorateve, të cilat do të kenë ndryshime strukturore. Ndoshta kjo është arsyeja që jemi në këtë lloj vakumi. Jam i bindur se në vazhdim do të ketë një zgjidhje afatgjate për këtë problem.

Për sa i përket pjesës së matricës, që ju me të drejtë theksoni, nëse ka një afat se kur përfundon, sigurisht që kemi një afat, i cili është parashikuar në fund të nëntorit dhe po bëjmë testimet e fundit. Kështu që mendoj se në fillim të dhjetorit matrica do të jetë aktive në faqen tonë të web-it, e cila rrit transparencën në mënyrën më të mirë të mundshme...

Adelina Rista – Zoti Seferi, ju falënderoj ju dhe ekipin tuaj dinjitoz dhe serioz në paraqitjen e gjithë punës së bërë në këtë 9-mujor! Ju dëgjova me vëmendje, gjithashtu raportin

e kemi përpara, dihet që çështjet e punësimit dhe problematikat që lidhen me të janë tepër sensitive, ato prekin dhe ndiejnë si punëdhënësit, ashtu edhe punëmarrësit në të gjitha familjet shqiptare.

Raportin tuaj e kam hapur te faqja 4, ku janë arsyet e ankesave. Aty shikoj se numri më i madh i ankesave është për mospagesat e pagave të prapambetura, te ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe mospagesa e sigurimeve shoqërore. Ky është numri më i madh i ankesave drejtuar inspektoratit tuaj.

Atëherë, referuar temës së këtyre ankesave, unë i përmbledh në një të përbashkët, që i lidh të gjitha informaliteti. Pra, kjo do të thotë se në vendin tonë ka informalitet. Atje ku ka informalitet, ka punëdhënës të pandërgjegjshëm ndaj detyrimeve që kanë, ka punëmarrës që u shkelen të drejtat. Ju dëgjova me vëmendje, ku thatë se keni ushtruar kontroll sipas ligjit. Por, gjithashtu, thatë se keni mangësi në numrin e inspektorëve, pra në staf për të ushtruar kontrollin që duhet. Kuptohet, të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që nuk mund ta ushtroni dot detyrën ashtu siç duhet me këtë numër kaq të vogël punonjësish. Atëherë, detyra jonë si parlamentarë është që të ushtrojmë përgjegjësinë dhe detyrën tonë. Pra, që ligji nr. 121 të bëhet i zbatueshëm, ne duhet të ushtrojmë fort detyrën tonë për nxjerrjen e akteve nënligjore. Kjo është detyra jonë.

Meqenëse tani jemi në prag të diskutimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, a keni bërë kërkesë për shtim të numrit të punonjësve, për ndryshim të strukturës, sepse kjo është e domosdoshme?

Pyetja e dytë ka të bëjë me inspektorin e Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore. Do ta konkretizoj shumë thjesht, edhe në mandatin e kaluar, në këtë komision, kur kemi folur kujdesin shëndetësor, shërbimin social, për luftën ndaj shfrytëzimit dhe diskriminimit të të miturve apo shtresave në nevojë, kam bërë një pyetje, të cilën do ta përsëris: Shërbimi Social Shtetëror jep raportin për peronat me aftësi të kufizuara, e kam fjalën për ata që janë, sepse janë disa kategori, të cilat janë në gjendje të rëndë dhe të patjetërsueshme, por, gjithashtu, jep edhe pagesën për një kujdestar. Atëherë, i sëmuri që është në këtë gradë ka edhe një kujdestar që kujdeset, zakonisht është një person i familjes që merr pagën. Por ne në rrugët e të gjitha qyteteve të Shqipërisë shikojmë njerëz, të cilët janë të paaftë të dalin vetë në rrugë, që janë me karrocë, ose me paterica, ose janë të gjymtuar dhe nuk dalin dot vetë. Pra, për këta individë që marrin një pagesë paaftësie nga shteti paguhet edhe një person i dytë, që të kujdeset për to po nga shteti. Atëherë, ky person i dytë që kujdeset për ta i nxjerr në rrugë, duke i shfrytëzuar, njëkohësisht duke i diskriminuar. Për këtë peron të dytë, që merr pagesën nga shteti për t'u kujdesur për personin e sëmurë, a ka detyrim inspektori i kujdesit shëndetësor të shkojë dhe ta kontrollojë? A keni kontrolluar ndonjë të tillë? A keni marrë masa ndaj ndonjë

personi të tillë duke i ndërprerë pagesën e kujdestarisë e të tjera? Këto janë tema që na prekin të gjithëve, që shteti, me mundësitë që ka, investon për t'u kujdesur për këta persona me aftësi të kufizuara dhe, nga ana tjetër, këta persona shfrytëzohen.

Unë kam nxjerrë disa foto, sepse më rrëqethet mishi kur shikoj persona të tillë, gjysmë të zhveshur, që zvarriten në rrugë, në mes të makinave, që nuk kanë dalë vetë, por i ka nxjerri tjetërkush për t'i shfrytëzuar. Nëse dikush u jep lëmoshë këtyre personave, ata nuk e përdorin vetë, por është dikush tjetër që i shfrytëzon.

Ariana Pëllumbi – Është e vërtetë.

Pjesa e ndihmës ekonomike që përfshin kujdestarin e personit me aftësi të kufizuara është në kompetencë të Shërbimit Social Shtetëror. Ndërsa për sa i përket pjesës që përfshin kontrollin në familje, kontrollin në shtëpi, kontrollin në rrugë, kontrollin e të gjithë komunitetit, këtë ne nuk e bëjmë dot, sepse është pjesë e ligjit të ri, ku janë futur gjithë këto shërbime të reja që ne duhet t'i kontrollojmë, aktet nënligjore për shërbimet komunitare, për të cilat duhet të përgatitet një model me standarde, ku ne duhet të futemi dhe të përcaktojmë që këto shërbime duhet të kontrollohen edhe nëpërmjet kontrollit të bashkisë, që, së pari, ka gjithë komunitetin e vet, dhe së dyti, me vërtetë, ne duhet të kontrollojmë rastet më tipike. Në këtë mënyrë ne mund të dalim me konkluzione se çfarë mund të bëhet me këtë pjesë.

Adelina Rista - Domethënë, sot për sot nuk është objekt i kontrollit tuaj, por duhet rregulluar me akte nënligjore.

Ariana Pëllumbi – Patjetër.

Adelina Rista – Faleminderit!

Ariana Pëllumbi – Për sa i përket institucioneve të përkujdesit shoqëror, që në të gjithë territorin janë rreth 296, janë bërë kontrole rutinë, por duke u bazuar në ligj, që të paktën dy herë në vit duhet të kontrollohen, ne as këtë mundësi nuk e kemi me 4 inspektorë që jemi.

Projektbuxheti për strukturën e re është bërë dhe i është dërguar Ministrisë së Financave edhe për vitin 2019, kështu flas për pjesën time, me gjithë strukturën e re që mendohet të bëhet, ku është parë ngarkesa e inspektorëve për të gjithë kompetencat që marrin.

Adelina Rista – Faleminderit!

Elisa Spiropali - Kam vetëm një konstatim, para se të flasë zonja Xhembulla.

Ju shkruani te raporti se për sa i përket cilësisë së ofruar në qendrat e shërbimit privat është më e mirë, përgjithësisht nga konstatimet tuaja, se ato të shërbimit publik. Në fakt, ky nuk është një lajm i mirë, duke qenë edhe një maxhorancë e majtë, ne mendojmë se publikja i ka të gjitha mundësitë për të ofruar shërbime të një standardit të lartë. Sipas gjykimit tuaj, është

çështje e kapaciteteve të punonjësve të këtyre institucioneve, pra janë njerëz të pakualifikuar, në shumicën e tyre, ata që punojnë në institucione?

Së dyti, që lidhet me këtë, po jo posaçërisht, punonjësit tuaj si trajnohen, pra punonjësit e inspektoratit, përgjithësisht kur janë marr në punë, sa kohë kanë aty dhe si janë trajnuar, sepse edhe kjo është e rëndësishme? Vërtet mund të keni një numër të vogël, por nëse ata janë më efikasë, atëherë mund të rrisni dhe inspektimet.

Arben Seferi – Zonja kryetare, evidentimi i kësaj problematike që sapo thatë është shumë i saktë. Unë do ta filloj me pjesën e trajnimeve, që ju i përmendët në fund. E vërteta është se ne kemi një trupë trajnuese pranë institucionit, e cila në mënyrë permanente bën trajnimin e kryeinspektorëve rajonalë dhe të inspektorëve. Kemi një grafik për mënyrën se si i bëjmë trajnimet dhe në varësi të rasteve specifike të ndryshme që ne hasim në terren, me qëllim që qartësisht të japim dhe zgjidhjet në përgjigje dhe në zbatueshmëri të ligjit, bëjmë edhe trajnimet për sa u përket çështjeve konkrete. Sigurisht, pjesë e trajnimeve, të cilës realisht i mëshojmë fort, është etika, e cila fillon me mënyrën e sjelljes së inspektorëve dhe me mënyrën e paraqitjes pranë çdo lloji subjekti shtetëror apo privat. Kështu që gjatë kësaj periudhe që unë kam në institucion...

Elisa Spiropali – Ata trajnohen në mënyrë të përvitshme apo një herë në 6 muaj?

Arben Seferi – Ne gjatë kësaj periudhe kemi bërë trajnime intensive, domethënë, për 5 muaj kemi bërë 6 trajnime. Pse?! Sepse në çdo moment vëmë re që inspektorët, pavarësisht viteve të punës që kanë, hasin problematika nga më të ndryshmet. Kështu që për këtë arsye trajnimet nuk i organizojmë sipas një grafiku vjetor, por, për shembull, për 5-6 muaj ne i kemi bërë 6 trajnime të gjithë trupës inspektuese. Ndërsa për pjesën tjetër, nga kontrollët që kemi bërë si taskforcë (ministria dhe ne, si inspektorat) është vënë re në një pjesë, mospërputhje të vendit të punës me personin, ose nuk ka pasur figura profesionale (psikiatër, neuropsikiatër për qendrat e zhvillimit), apo figura që kanë specialitet shumë specifik. Kjo e ngre shumë cilësinë e shërbimit në këto qendra. Ne i kemi mëshuar fort pjesës së figurave profesionale.

E dyta, është për pjesën e trajnimeve. Në detyrat që kemi lënë vazhdimisht gjatë procesit të inspektimit, kanë qenë edhe trajnimet (trajnimet rutinë, si dhe trajnimet e veçanta për figura të veçanta të stafit).

Elisa Spiropali – Ju lini rekomandime për institucionet, për bashkinë dhe për të tjerët?

Ariana Pëllumbi – Po.

Elisa Spiropali – Pra, pasi evidentoni që në vendin e psikologut nuk është një i tillë, por është një person me një tjetër profesion, atëherë ju lini rekomandime, detyra për bashkinë dhe për të tjerët.

Ariana Pëllumbi – Po, sidomos për bashkinë, sepse një pjesë e mirë e tyre janë të bashkisë.

Elisa Spiropali – Zbatohen këto rekomandime?

Ariana Pëllumbi – Përgjithësisht janë zbatuar, por ka edhe ndonjë rast që nuk është zbatuar.

Elisa Spiropali – Dakord.

Urdhëroni, zonja Xhembulla!

Almira Xhembulla – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Falënderoj zotin kryeinspektor dhe të gjithë stafin për prezantimin e punës 9-mujore dhe për raportin që na kanë vënë në dispozicion!

Që të mos bie në përsëritje, desha të pyes, duke qenë e ndërgjegjshme për shqetësimin që ju ngritët për sa i përket numrit të limituar të punonjësve që keni në varësinë tuaj, duke pasur parasysh edhe gamën e madhe të problematikave, desha të them se sigurisht ju funksiononi mbas kampionimit dhe mënyrës se si inspektoni apo në bazë të çështjeve dhe shqetësimeve që ngrihen në kuadër edhe të ankesave që merrni, kështu që edhe siç ju e referuat si shqetësim, por unë desha të pyes drejtpërdrejt: a kanë frikë subjektet nga Inspektorati i Punës? Duke qenë se e gjithë reforma jonë kryesisht në mandatin që kaluam dhe unë jam shumë e bindur se kemi bërë shumë hapa përpara në këtë aspekt.

Adelina e theksoi se ka informalitet. Patjetër ka, se ka shumë vende më të zhvilluara se ne, të cilat nuk kanë arritur dot ta zhdukin komplet, këtë fenomen, por dua të them se ka një ndërgjegjësim dhe tani janë më të vëmendshëm dhe më të kujdesshëm (besoj se me këtë jemi dakord të gjithë) dhe ju e shprehni këtë edhe në raport se rritja e numrit të ankesave, tregon se njerëzit janë ndërgjegjësuar tashmë që ky fenomen ashtu siç ishte, nuk shkon më.

Ndërkohë, desha t'ju pyes përpos kësaj për numrin e aksidenteve në punë, që lidhet me industrinë minerare. Meqë jam përfaqësuese e qarkut të Dibrës, desha të ndalem për të marrë shkurtimisht një informacion më të detajuar se si është situata me kompanitë e kromit.

Ju thoni se për sa u përket aksidenteve të nëntokës, nuk keni kompetencë të drejtpërdrejtë. Kush e ka këtë kompetencë të drejtpërdrejtë? Çfarë do të thotë shprehja “nuk kemi kompetencë të drejtpërdrejtë”?

Kisha dhe një pyetje tjetër. Meqenëse ju e referuat si një ndër arritjet edhe përmirësimin e faqes suaj të internetit në të cilën përmendni se është rritur numri i vizitorëve

jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj. Mos kjo varet nga numri i atyre subjekteve, që duan të investojnë? Si e shpjegoni ju këtë rritje të numrit të të huajve, që vizitojnë faqen tuaj?

Arben Seferaj – Faleminderit për pyetjet, zonja deputete!

Po e nis me pyetjen e dytë, që i përket shikueshmërisë së faqes sonë të internetit. Unë nuk e përcaktoj dot, por me gjasa jam i bindur se edhe personat që jetojnë në kontinentet e tjera, që e hapin faqen tonë, janë shqiptarë, të cilët interesohen për legjislacionin e punës dhe për çdo gjë që ka të bëjë me aspektin e punësimit në Republikën e Shqipërisë. Fakti që është rritur numri i përdoruesve (shkon 80-100 vizitorë në ditë), tregon një ndërgjegjësim të të gjithë njerëzve, që përfshijnë edhe punëdhënësit, edhe punëmarrësit, të cilët njihen me legjislacionin e punës dhe me ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë. Pra, ky është një tregues pozitiv.

Sigurisht, kjo lloj qasjeje na rezulton edhe tek aksidentet. Kur e sheh në momentin fillestar mund të thuash se janë rritur aksidentet dhe për këtë fakt duhet të mërzitemi, por ne kënaqemi për një gjë tjetër, për faktin se këto aksidente tani deklarohen. Deri dje nuk deklaroheshin dhe në momentin që një aksident nuk deklarohet, i aksidentuari nuk përfiton absolutisht asnjë gjë. Fakti që këto ankesa janë rritur, tregon ndërgjegjësimin e subjekteve për të deklaruar aksidentin, me qëllim që çdo i aksidentuar të përfitojë nga skema e sigurimeve shoqërore. Prandaj, në këtë aspekt, ne jemi të kënaqur me këtë lloj reflektimi pozitiv.

Për sa i përket qarkut të Dibrës duke ditur që ai është një nga qarqet me sasi të mëdha minerali, sigurisht aty është përqendruar edhe industria minerare. Aktualisht në qarkun e Dibrës është fokusuar edhe puna e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe puna e shërbimeve shoqërore, pikërisht në industrinë minerare.

Elisa Spiropali – A keni kompetencë ju për industrinë minerare?

Arben Seferaj – Po, kemi. Do t’ju shpjegoj tani. Sigurisht, ne kemi kompetencë për të kontrolluar marrëdhëniet e punës për çdo subjekt në RSH, qoftë ky minierar, tregtar apo me çdo lloj tagri tjetër.

Elisa Spiropali – Këtu ka një ngërç të pashpjeguar se isha kurioze dhe meqë e ngritit edhe zonja Xhembulla.

Arben Seferaj – Po. Ligji parashikon që në subjekte të caktuara, ku janë përfshirë edhe minierat, janë drejtori të caktuara pranë ministrive përkatëse, të cilat merren me eksplorimin ligjërish të problemit. Në rastin konkret i vetmi ngërç, që nuk na jep të gjithë hapësirën e mundshme për të vepruar, është në rastin e minierave, ku për çdo aksident që ndodh në thellësi të tokës, është ekskluzivisht i ndjekur nga AKSEM (Autoriteti i Sigurisë dhe i Emergjencave në Miniera).

Elisa Spiropali - Nga varet ky autoritet?

Arben Seferaj – Ai varet nga ministria përgjegjëse për energjinë.

Për sa u përket aksidenteve që ndodhin mbi tokë, sigurisht ne kemi të gjithë tagrin dhe të drejtën ligjore për të ushtruar kompetencat tona dhe për të marrë dhe për të dhënë zgjidhjet, që i takojnë çdo çështjeje.

Cila ishte pyetja tjetër?

Almira Xhembulla – Pyeta për rastin e aksidenteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Seferaj – Absolutisht. Aty ka një specifikë të caktuar, që e përmenda edhe pak më parë, duke qenë se e gjithë zona është zonë minerare, ku ndodhin shumë aksidente te njerëz, të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie me kompaninë, sepse e mbledhin mineralin vetë dhe e çojnë në pikën e grumbullimit. Normalisht, këtu del jashtë mundësisë sonë për të bërë diçka, prandaj duhet bashkëveprimi ndërinstitutional që e përfshin këtë fushë, pa diskutim, por përfshin edhe SHRSF-të...

Flamur Golemi – Faleminderit zonja kryetare!

Falënderoj zotin Seferaj dhe stafin për prezantimin!

Unë shpresoj se qoftë ky takim, qoftë nisma për takime të tjera, për nismat apo ndryshimet ligjore duhet t'i japin peshë Inspektoratit të Punës, së pari, siç u tha edhe prej jush, për të mirën e punëmarrësit.

Unë lexova edhe në raportin 9-mujor të vitit 2018. Inspektimet kanë qenë të shumta dhe, sigurisht, ka njolla më të nxehta, por ka edhe zona më të qeta.

Po marr shembull qarkun e Gjirokastrës që unë përfaqësoj. Sigurisht, ka biznese dhe firma tejet serioze, sidomos në industrinë ushqimore, por qoftë edhe paraqitja herë pas here e personelit, pra e inspektorëve, te këto lloj firmash nganjëherë lë për të dëshiruar.

Perceptimi, të paktën deri dje, për të cilin do të doja ta përgëzoja kryeinspektorin për formatin dhe ndryshimin që ka pësuar në këtë periudhë ky Inspektorat, qoftë edhe nga inspektimet *online*, që tashmë bëhen në të gjithë terrenin (nga çfarë më kanë thënë vetë bizneset dhe pronarët e firmave, të ndërmarrjeve të këtij qarku më parë ka pasur problematika), por pjesa e inspektorëve, çka u përmend edhe nga kolegja Spiropali, duhet të shikohet me vëmendje për nga integriteti i tyre dhe arsimimi. Kjo është një detyrë që duhet ta bëni. Do të keni mbështetjen e komisionit, po se po, siç e thashë, për çdo ndryshim ligjor apo qoftë për çdo nismë që do të paraqitet edhe për shtimin e numrit të punonjësve në strukturën tuaj. Por brenda Inspektoratit të Punës nuk mund të lejohen ende njerëz gjobëvënës, në kuptimin e plotë të fjalës.

U përmend edhe nga kolegu doktor më parë për sa i përket kujdesit shëndetësor, është edhe në fokusin e Inspektoratit të Shëndetësisë, se ka ndërmarrje me më shumë se 700 punonjës. Aktualisht jemi në muajin e ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit. Ka fasone, për të cilat unë do të thosha se janë edhe problematike, pra jo vetëm ata të sigurisë private, por edhe minierat dhe fasonet janë problematike. Ka fasone që punësojnë numër të caktuar dhe shumë të madh grash dhe minimumi mjekët që duhet të jenë aty, miqtë e mi, mjekët janë formalë.

Po të shkojmë sot te një biznes, përveçse është ndërmarrje vërtet serioze, nuk besoj që punonjësi atje të ketë një kartelë mjekësore, ndërkohë që mund të ndërmerret nisma për të pasur kartela elektronike. Është shumë e thjeshtë. T'i vihet detyrim kartela elektronike, e cila monitorohet dhe vetë personi... Sepse shumë herë punëmarrësit nuk e çojnë zërin që të ankohen.

Është detyra jonë. Unë ju falënderoj për punën dhe për ndryshimin e imazhit që i keni dhënë Inspektoratit, por besoj se duhet edhe më shumë punë për t'i dhënë forcën dhe fuqinë e duhur!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Seferaj – Faleminderit, zoti deputet!

Bie shumë dakord me gjetjet që sapo thatë për sa i përket çështjes së korrupsionit, pra atyre “gjobëvënësve” që ju përmendni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam totalisht dakord, pa asnjë rezervë, për sa thoni, madje kjo është edhe arsyeja pse i dhashë rëndësinë e duhur pjesës së matricës, që e përmenda pak më parë.

Për ta ilustruar me një shembull, për t'jua qartësuar sa më thjesht se si do të funksionojë dhe për të kuptuar se çfarë reagimi do të ketë nesër pasi ajo të bëhet aktive, duke qenë se inspektori i Punës ka në diskrecionin e tij, pra ia lejon ligji, një hapësirë shumë të madhe kur vendos masën administrative (duke e pasur, për shembull, zero deri në 20-fish, zero deri në 50-fish, 10 deri në 30-fish ose deri në 50-fish të pagës minimale), pikërisht këtu qëndron edhe ai sekret, si të thuash, dhe “zgjuarsia e tyre” për t'i bërë presion biznesit.

Do ta ilustroj me një shembull shumë të qartë dhe të kuptueshëm edhe për ju. Është njësoj sikur, po ju drejtohem shumë miqësisht tani, i shkon kontrolli Elisës në subjektin e saj dhe ajo nuk di gjë, as i njeh inspektorët... Sigurisht që për shkeljen e evidentuar ata e kanë në diskrecionin e tyre...

Elisa Spiropali – Mbledhja po regjistrohet.

Arben Seferaj – Nuk ka problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë prandaj e bëra të thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më tej do të marr shembull veten.

Çfarë ndodh? Në momentin që nuk njih njeri, je e panjohur me shumë gjëra, inspektori, duke e pasur në diskrecionin e tij për shkeljen që të kap, të fut te ligji nga zero deri në 10-fish të gjobës, madje të bën presion se do të të vendosë gjobën maksimale. Sigurisht, sjellja e biznesit është e ndryshme. Dikush thotë: “Vëre!”, dikush tjetër thotë: “Prit, mos më masakro, por më bëj një gjë” dhe gjen atë formulën e mesme: “Na këto lekët, mua më shkruaj një gjobë minimale dhe ta mbyllim këtë histori”. Ky është realiteti që unë e kam parë me sytë e mi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni!

Pra, për të njëjtën shkelje që shkuan, për shembull, tek Elisa dhe bënë atë lloj veprimi, tani vijnë te Beni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, vijnë te Beni dhe ky i fundit i thotë: “Ore, më kape këtë shkeljen ti mua?”, “Po”, ia kthen inspektori. “Njëzetëfishin do të më japësh gjobë mua”? Ai përgjigjet: “Nuk kam çfarë të bëj, se më detyron ligji”. Unë shtoj: “Prit, ore vëlla, se ligjin e rregullojmë ne. Merri këto lekët...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ti zero deri në 20-fish e ke. Mua do të më vësh zero, një shkelje kështu kot dhe mbyllet historia”.

Tani, çfarë kemi bërë ne te kjo matricë për të mos pasur histori të kësaj natyre? Ne e kemi ndarë në segmente, atë zero deri në 50-she. Ne kemi nxjerrë zero deri në 5-fish; 5-fish deri në 10-fish, 10 deri në 15-fish, 15-fish deri në 20-fish e kështu deri te shifra 50, duke thënë: kur inspektimi është për herë të parë, ti me ligj nuk i vendos dot gjobë, por e informon, e këshillon, madje i lë edhe detyra.

Kur ti i shkon për kontroll për herë të dytë, vete i gjen një shkelje, ti nuk mund ta masakrosh biznesin, se e shohim edhe në forma ku biznesi është partner. Për të qenë të sinqertë, po të mos jetë ai biznes, nuk ka vende pune.

Atëherë, ti, zotëri, do t’i vësh gjobë nga zero deri në 5-fish, sepse gjobën do ta marrë ai, nuk diskutohet, për shkelje, ama nuk do të shkosh këtu te kjo. Ti e ke në diskrecionin tënd, mund t’ia vësh, por do të padisësh veten. Pse? Sepse ai do të vijë pranë Komisionit të Apelit

të Gjobave, ku ne do t'i vëmë në dispozicion pikërisht atë matricë dhe do t'i themi: për këtë shkelje ke bërë këtë, këtë dhe direkt pastaj kalon në masë disiplinore për inspektorin që ka bërë praktikën.

Prandaj them se transparenca në këtë rast rritet në mënyrë maksimale edhe për subjektin, edhe për inspektorin, aq sa ne themi se kjo matricë “rrit inteligjencën” e inspektorëve, sepse i detyron të sillen në këtë formë.

Edlira Bode – Meqenëse e kthjem në një bashkëbisedim miqësor, po marr një rast: ndodh që shkon inspektorati me inspektorët e tij të bëjë kontrollin dhe e gjen subjektin në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më ndodhi kur ne bëmë një takim të bashkëqeverisjes.

Qytetarët e një zone u ngritën dhe u ankuan ndaj një subjekti privat për ndotje mjedisi dhe për punësim të pasiguruar të punëtorëve. Inspektorët shkuan të nesërmen, por e gjetën në rregull. Në fakt, atë ditë ai kishte marrë në punë vetëm punonjësit e deklaruar. A ndodh të përsëritet në distancë kontrolli për të njëjtin subjekt, edhe pse gjendet në rregull herën e parë kur ka indicie?

Arben Seferaj – Absolutisht po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Shkurtimisht, ju lutem, sepse deputetët kanë edhe impenjime të tjera.

Arben Seferaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, ndodh.

Në momentin që kemi indicie...

Po, gjoba është titull ekzekutiv.

Elisa Spiropali – Atëherë, zoti Seferaj, unë ju falënderoj shumë për të gjithë prezantimin shterues që bëtë! Falënderoj edhe të gjithë deputetët, të cilët kishin pyetje dhe ishin tejet të angazhuar në këtë seancë dëgjimore, si dhe stafin tuaj! Gjithashtu, përgëzime për punën e bërë këta gjashtë muaj, pasi dukshëm është rritur edhe numri i kontrolleve, cilësia dhe produkti juaj! Ne do të na keni në krah për ato nevoja që ju keni, ashtu sikurse do t'ju thërrasim përsëri për të parë rezultatet e punës suaj në vazhdim.

Mbetet vetëm që ne të bëjmë një raport nga kjo seancë dëgjimore.

Faleminderit!

Arben Seferaj – Ju falënderoj!

Elisa Spiropali – Ka mekanizma për të parë se si kanë rezultuar në punë.

Faleminderit edhe një herë!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA